



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 294

Datë: 15.06.2022


Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (h), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008", bazuar në nenin 9 paragrafi 3 shkronja (a), nenit 10, nenit 19 paragrafi 1 shkronja (a), të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Vendimit Nr.02/514 datë: 12.09.2029, propozimit Nr.01/867 datë: 06.06.2022 të Këshillit Organizativ, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më datë: 13.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për ndarjen e çmimit "**IMER KRASNIQI**" - për Trimëri dhe Heroizëm për Shpejtim Ali Hazrollin (pas vdekjes), nga fshati Banjë Komuna e Malishevës, ish veteran i Brigadës 122.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi, çmimi i ndahet nga Kuvendi i Komunës së Malishevës më datë: 13.06.2022 dhe i njëjti mbështetet në Statutin e Komunës së Malishevës.
3. Çmimi do të jepet publikisht më datë: 16.06.2022 me rastin e shënimit të 23-vjetorit të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorive komunale.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.





ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



MALISHEVË

Nga: Nga OVL(Organizata e Veteranëve të luftës së UÇK-së)dega në Malishevë

Biografi e shkurtër për Veteranin e UÇK-së Shpejtim Ali Hazrolli;

Shpejtim Ali Hazrolli Lindi me 15.12.1968 në Banjë Komuna Malishevë.

Ishte me pregatitje teknik I Ekonomis.

Me të filluar lufta në vitin 1998 dhe pas ramjes Heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, shumë djem dhe vajza ju përgjigjen kushtrimit për atdhe, ku një ndër ta ishte edhe Shpejtim Ali Hazrolli.

U inkuadrua në njësitin Lumi në vitin 1998 ishte ushtar trim dhe i fjalës, mori pjesë në shumë beteja si në Bllacë, Rahovec e shumë vende tjera ku ishte nevoja.

Duke parë aftësitë e tij ushtarake komanda e Brigadës 122 Imer Krasniqi emron Komandant të Kompanisë në Batalionin e parë në këtë Brigadë.

Deri në përfundim të luftës ishte aktiv, pas përfundimit të luftës shërbeu në TMK-për tri vite, pas kësaj ju kthye jetës civile deri në vitin 2020 ku dhe nga një smundje e randë vdiq në këtë vitë.

OVL në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2022 merr vendim unanim që këtë vit qmimi për Heroizem dhe Trimni Imer vKrasniqi të ndahet post mortum Shpejtim Ali Hazrolli.

Punuar në 4(dy)kopje

1x1 -titullit të përmendur.


1x1 -arkivit

Me Respekt;

Kryetari i OVL- UÇK-së
Metush Kryeziu



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/867

Datë: 06/06/2022

Nga:

Kryetari i Komunës së Malishevës

Kryetar i Këshillit Organizativ, Eksp. Kastrë

Për:

Kuvendi i Komunës së Malishevës

Datë:

06.06.2022

Kopje:

Arkivit të komunës

Lënda:

Propozim për miratim të vendimit të Këshillit Organizativ, për ndarjen e mirënjohjeve konform nenit 9 të Statutit të Komunës së Malishevës.

Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Këshilli Organizativ i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, Vendimi nr.02/212, të datës,05.05.2022, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit, vendosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të komunës së Malishevës, të nominojë këto personalitete.

Këshilli Organizativ i propozon Kuvendit të Komunës së Malishevës për miratim:

Për çmimin "Imer Krasniqi" Këshilli Organizativ, vendosi që të dërgon në kuvend propozimet e Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare-dega në Malishevë;

- 1. Shefqet Paçarizi (pas vdekjes).
- 2. Shpëtim Hazrolli (pas vdekjes)

Për çmimin "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë në shkollën shqipe,

- 1 z. Kapllan Krasniqi.
- 2 z. Haxhi Berisha.

Për çmimin "Shpëtim Robaj" për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;

- 1. Inf. Ismet Morina (pas vdekjes).
- 2. Dr. Gëzim Krasniqi.

Ju faleminderit për mirëkëmbim !

Me respekt,

Zyra e Kryetarit të Komunës
Rruga "Gjergj Kastrioti - Skenderbeu" - pn
24000-Malishevë